



DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

## VROJTIMI I AKTIVITETIT KREDITUES

### ROLI I TIJ PËR BANKËN QENDRORE DHE ASPEKTE METODOLOGJIKE

*Vrojtimi i aktivitetit kreditues ka për qëllim të monitorojë më nga afër zhvillimet në aktivitetin kreditues, duke pasuruar tablonë që përfshohet nga të dhëna sasiore (sipas raportimeve mujore të bankave) me të dhëna cilësore, të cilat nuk janë pjesë e raportimeve periodike. Ky vërtetim pasuron edhe analizën mbi tregjet financiare në vend, duke hedhur dritë mbi zhvillimet si në krahun e kërkesës ashtu edhe të ofertës për kredi, si edhe mbi politikën apo strategjitë kredituese të sistemit bankar. Për herë të parë, një vërtetim i tillë është prezantuar në ShBA, rreth viteve '60, ndërsa në Evropë në vitin 2003. Në Shqipëri, vërtimi i aktivitetit kreditues ka filluar të përpilohet në vitin 2007. Analiza mbi këto rezultate publikohet në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë që prej gjashtëmujorit të dytë të vitit 2007.*



### **Pse është i rëndësishëm vrojtimi mbi aktivitetin kreditues për bankën qendrore?**

Së pari, zhvillimet në aktivitetin kreditues ndikojnë gjerësisht ecurinë e aktivitetit ekonomik dhe luhatjet në ciklet e biznesit. Teorikisht, rritja e kreditimit në vend mbështet rritjen ekonomike dhe anasjelltas. Ky vrojtim pasuron analizën mbi ecurinë e kreditimit në vend nëpërmjet informacionit që ofrohet nga standardet e aplikuara nga bankat, kushtet çmim dhe joçmim, perceptimit të rrezikut nga ana e bankave dhe gatishmërisë së tyre për të kredituar ekonominë. Informacioni i përfutur nga vrojtimi i aktivitetit kreditues ndihmon për të kuptuar më nga afër përqasjen e bankave drejt kreditimit të ekonomisë. Në këtë kontekst, ai plotëson me të dhëna cilësore, vlerësimet mbi ecurinë e treguesve ekonomikë (konsumi, investimet, prodhimi, etj.), monetarë dhe financiarë, mbi tërësinë e të cilave ndër të tjera bazohet dhe vendimmarrja e politikës monetare.

Së dyti, ai pasuron setin e informacioneve lidhur me mekanizmin e transmetimit të politikës monetare. Teorikisht dhe praktikisht, vendimet e politikës monetare transmetohen në ekonomi nëpërmjet kanaleve të ndryshme. Sipas konceptit bazë të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare, banka qendrore ndikon në shpërndarjen ndërkohore të burimeve, nëpërmjet ndryshimeve mbi normën e interesit (instrumenti kryesor i politikës monetare). Megjithatë, banka qendrore kontrollon vetëm segmentin afatshkurtër të normave të interesit. Përcjellja e këtyre ndryshimeve në segmentin afatgjatë ndikohet, ndër të tjera, nga bankat tregtare nëpërmjet normave që ato aplikojnë mbi kreditë dhënë sektorit privat në ekonomi. Shkalla e përçimit të ndryshimeve nga norma bazë në normën afatgjatë varet nga përqasja e sistemit bankar për kreditimin e bizneseve dhe individëve, kushtet e ofertë – kërkesës, si edhe struktura e sistemit bankar.

Së treti, një prej shtyllave, mbi të cilat është konceptuar dhe hartuar ky vrojtim, është ajo e pritjeve. Përpunimi i informacionit nga kjo pjesë e vrojtit, ndihmon bankën qendrore për të plotësuar tërësinë e informacionit lidhur me pritjet për kreditimin e ekonomisë, duke ndihmuar në parashikimet për treguesit monetarë dhe makroekonomikë (rritja ekonomike, investimet, konsumi, etj.).

### **Struktura e vrojtit**

Në terma të përgjithshëm, ky vrojtim është njehsuar me atë të ndjekur nga BQE, si në mënyrën e konceptimit ashtu edhe në aspektin metodologjik. Megjithatë, vrojtimi është përshtatur në disa segmente me specifikat e veprimit të sektorit bankar shqiptar (si p.sh. segmenti i pritjeve lidhur me kompozimin e kreditimit sipas monedhës, normat e interesit të aplikuara etj.).

Struktura e vrojtit të aktivitetit kreditues përbëhet nga pesë seksione: kredia për biznese, kredia për individë, pritjet për aktivitetin kreditues, statusi i aplikimeve për kredi dhe rubrika e veçantë. Dy seksionet e para kanë pothuajse të njëjtën strukturë, dhe në terma të përgjithshëm, ofrojnë informacion mbi ofertën dhe kërkesën për kredi, si edhe për faktorët që i ndikojnë. Në kahun e ofertës, krahas standardeve të aplikuara për kreditë dhënë bizneseve e individëve, trajtohen edhe faktorët që kanë shtyrë bankat të ndryshojnë standardet e kreditimit nga një tremujor më parë. Në të njëjtën kohë, nga vrojtimi merret informacion edhe mbi kushtet dhe termat që kanë mundësuar ndryshimin e standardeve të kreditimit, i plotësuar nga faktorët që kanë diktuar ndryshimin e këtyre kushteve. Në kahun e kërkesës për kredi përfitohet informacion nga perceptimet e bankave mbi kahun në të cilin ka ndryshuar kërkesa e sektorit privat, si dhe për faktorët pas këtij ndryshimi nga një tremujor më parë.



Pjesa e tretë e vrojtimit, ajo e formuluar për pritjet, paraqet perceptimet e bankave lidhur me kahun e ndryshimit të standardeve të kreditimit (oferta për kredi) dhe kërkesës për kredi (e bizneseve dhe individëve) në tremujorin e ardhshëm. Në këtë seksion, në ndryshim nga vrojtimi i BQE-së, përftohet informacion shtesë rreth pritjeve të bankave për ofertën dhe kërkesën e kredisë (biznese dhe individë) dhe normën e pritur të interesit për kredinë si në monedhën vendase ashtu edhe në atë të huaj.

Pjesa e katërt ilustron situatën e aplikimeve për kredi të refuzuara prej bankave të nivelit të dytë (pa përfshirë kërkesat për kredi prej të cilave janë tërhequr vetë individët/bizneset). Rezultatet mbi kahun e ndryshimit të aplikimeve të refuzuara plotësohen dhe me arsyet që kanë shtuar/pakësuar raportin e kredive të refuzuara ndaj totalit të aplikimeve për kredi.

Pjesa përmbyllëse e vrojtimit, rubrika e veçantë, formulohet nga pyetje *ad hoc*, të cilat trajtojnë çështje specifike aktuale në aktivitetin kreditues, të paadresuara nga pyetjet standarde të formularit. Informacioni i përpunuar nga kjo pjesë e vrojtimit, përgjithësisht shërben për të kuptuar më nga afër situata specifike në tregun e kredisë, të cilat nuk shpjegohen plotësisht nga informacionet e disponuara me frekuencë të rregullt.

### Modalitete të përgjithshme

Vrojtimi i aktivitetit kreditues plotësohet në nivel drejtues të departamenteve përkatëse<sup>1</sup> të bankave tregtare, të cilët janë përgjegjës për ndjekjen nga afër të zhvillimeve në fushën e kredisë. Periudha të cilës i referohet vrojtimi në pyetjet e seksioneve 1, 2 dhe 4 është tremujori aktual kur shpërndahet pyetësori, ndërkohë që në pyetjet e seksionit 3 është tremujori i ardhshëm. Duhet theksuar që ky vrojtim nuk është një informacion i mirëfilltë statistikor dhe përgjithësisht bazohet në perceptimet e ekspertëve të kredisë mbi zhvillimet kryesore në ofertën dhe kërkesën për kredi.

Pyetësori dërgohet tek bankat brenda datës 20 të çdo fund tremujori. Bankat e kthejnë pyetësin e plotësuar jo më vonë se dy javë pas marrjes së tij. Rezultatet e këtij vrojtimi publikohen në faqen e Bankës së Shqipërisë me frekuencë 3 mujore (si në formën e analizës ashtu edhe të serive kohore), brenda datës 20 të muajit pasardhës të çdo tremujori.

Aktualisht, në këtë vrojtim marrin pjesë 11 banka, të cilat zotërojnë pjesën më të madhe të kredisë dhënë për sektorin privat. Kriteri i ndjekur në përzgjedhjen e tyre është zotërimi i të paktën 3% të stokut të kredisë akorduar sektorit privat. Si bazë për të llogaritur pjesën e tregut të bankave, të cilat përdoren në agregimin e rezultateve për secilën pyetje, shërben teprica e kredisë për sektorin privat në tremujorin paraardhës.

Metodologjia e përdorur në agregimin e rezultateve (sikurse dhe në rastin e BQE-së) i referohet treguesit të përqindjes neto. Në rastin e standardeve të kreditimit, ky tregues matet nga diferenca mes shumës së përqindjeve që janë përgjigjur “lehtësuar ndjeshëm” dhe “lehtësuar disi” me shumën e përqindjeve të të përgjigjurve “shtrënguar shumë” dhe “shtrënguar disi”, korrigjuar në secilin rast me peshën e secilës bankë në atë segment të kredisë. Përqindja neto në kahun negativ tregon shtrëngim të standardeve, dhe anasjelltas. Në formë matematikore, llogaritja e përqindjes neto në rastin e standardeve të kreditimit jepet si më poshtë:

<sup>1</sup> Në varësi të strukturës organizative që mund të ketë secila bankë, këto departamente mund të jenë të kredisë, të riskut, etj.



## Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues

---

$$\text{Përqindja neto (standarde)} = \sum \text{Përq. lehtësuar (shumë + pak)} - \sum \text{Përq. shtrënguar (shumë + pak)}$$

Në rastin e kërkesës për kredi treguesi agregohet në një të vetëm nga diferenca mes shumës së përqindjeve që janë përgjigjur “rritur shumë” dhe “rritur pak” me shumën e përqindjeve që janë shprehur “ulur shumë” dhe “ulur pak”, të korrektuar për peshën e secilës bankë në segmentin përkatës të kredisë. Forma matematikore e këtij treguesi është:

$$\text{Përqindja neto (kërkesa)} = \sum \text{Përqindja rritur (shumë + pak)} - \sum \text{Përqindja ulur (shumë + pak)}$$

Rezultati pozitiv interpretohet si rritje e kërkesës për kredi dhe anasjelltas.

Duhet theksuar se nga agregimi i përgjigjeve të bankave, përftohen indikatorë cilësorë, dhe jo sasiorë. Si të tillë, ata nuk interpretohen si në rastin klasik të të dhënave sasiorë, të cilat gjenerohen nga zyra statistikore, e që grumbullojnë informacion sasior në frekuencë të rregullt për një gamë të caktuar treguesish. Indikatorët cilësorë që përftohen nga vrojtimi i aktivitetit kreditues na shërbejnë për të kuptuar më në detaje zhvillimet në tregun e kredisë dhe plotësojnë informacionin nga raportimet me frekuencë të rregullt nga bilancet e bankave.

